



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01Nr 353/01-18076
Dt: 09.12.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke vendosur lidhur me formimin e komisionit për mbikëqyrjen e kontratës, me datë 09.12.2024 merr këtë:

V E N D I M

- Formohet komisioni për mbikëqyrjen e kontratës për shfrytëzimin e pronës komunale, me numër – 01-353/01-17778 e lidhur në mes Komunës së Gjakovës dhe “Fondacionin BONEVET Gjakovë”, në këtë përbërje:
 - Albana Bakalli - Kryesuese e komisionit
 - Selami Tuzi – anëtar
 - Fatbardha Dina – anëtare
- Komisioni i përshkruar si në pikën e parë të këtij vendimi, ka për detyrë dhe përgjegjësi që të ndërmer veprime konform legjislacionit në fuqi si vijon:
 - Të mbikëqyr realizimin e kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
 - Të përgatitë raporte të rregullta gjashtë (6) mujore të monitorimit, realizimit të kontratës dhe ta dorëzojë në zyrën e Kryetarit.
 - Në rast të evidentimit të shkeljes së kontratës apo shmangies nga qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës nga shfrytëzuesi, komisioni obligohet që në çdo kohë të njoftoj kryetarin e Komunës me shkrim, së bashku me rekomandimin e tij për shkëputje të kontratës apo masat tjera të përcaktuara në kontratë.
 - Të bëj faturimin për çdo vit dhe të njoftoj shfrytëzuesin për pagesë sipas kontratës.
 - Komisioni duhet të bëj dorëzimin -pranimi e pronës komunale, më së largu 10 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

